REPUBLIKA ESHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË

PLAN AFATMESËM
2023- 2027

Drejtore
Elona Qehajaj

I rishikuar Shtator 2024

Kryetar i Bordit drejtues
Fatos Cerenishti

1.HYRJE

Plani Afatmesëm 2023-2027 hartohet në kuadër të përcaktimeve të Udhëzimit NR. 14 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT".
Plani afatmesëm mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Aftësimit dhe Punësimit 2023-2030.
Prioritetet dhe objektivat strategjikë janë mbështetur në analizën e jashtme, analizën e brendshme, analizën SËOT, rezultateve të vetëvlerësimit, prioriteve dhe objektivave strategjike të Strategjisë Kombëtare për Aftësi dhe Punësim 2023-2030.

- ✓ Plani afatmesëm i punës së institucionit, hartohet me qëllim marrjen e masave për të realizuar objektivat e institucionit, bazuar në prioritetet që institucioni ka për 4 vitet në vijim.
- ✓ Plani afatmesëm po hartohet në një periudhë kur infrastruktura e godinës kryesore është rikonstruktuar, godinë e cila ka edhe numrin më të madh të klasave mësimore dhe laboratoreve që i shërbejnë përvetësimit të njohurive dhe aftësive praktike nga nxënësit.
- ✓ Grupi i punës është treguar i kujdesshëm në vendosjen e prioriteteve për 4 vitet e ardhme, duke synuar objektiva të cilat janë prioritare për institucionin dhe përcaktimin e aktiviteteve që bëjnë të mundur realizimin e tyre.
- ✓ Përgatitja cilësore profesionale e nxënësve dhe në përgjithësi rritja e cilësisë së përgatitjes së nxënësve, duke synuar formimin e qytetarit të denjë për shoqërinë tonë dhe profesionistit të kërkuar më shumë se kurrë nga tregu i punës, diktojnë hartimin e këtij plani 4 vjeçar zhvillimor të institucionit.
- ✓ Për të garantuiar cilësinë e përgatitjes profesionale të nxënësve në shkollë, institucioni kërkon mbështetje edhe nga institucionet qëndrore për përmirësimin me infrastrukturë të reparteve profesionale, si dhe ngritjen e reparteve që i mungojnë shkollës si dhe pajisjen e tyre me mjete dhe pajisje të domosdoshme për të realizuar procesin mësimor-edukativ, sidomos në Drejtimin mësimor "Teknologji Ushqimore" nga bizneset partnere si dhe donatorë apo organizata të ndryshme që kontribuojnë për një zhvillim cilësor të Arsimit Profesional në Shqipëri.
- ✓ Bazë e analizës vlerësuese për përcaktimin e objektivave dhe veprimtarive për realizimin e tyre, shërbejnë rezultatet e institucionit ndër vite, Analiza Sëot, rezultatet e nxënësve por edhe rezultatet në provimet e Maturës Shtetërore si dhe numri i nxënësve të punësuar pas përfundimit të shkollës.
- ✓ Një bazë e mirë për hartimin e këtij plani është edhe Vetëvlerësimi (vlerësimi i brendshëm) që institucioni ka kryer në vitet e fundit në të 5 fushat, rezultate të cilat japin të dhëna të plota për hartimin e Planit Afatmesëm.
- ✓ Parimi i gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimi, është pjesë integrale e këtij plani zhvillimor.
- ✓ Gjithashtu Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik, ndërlidhja me Ekonominë e Gjelbër, si dhe zhvillimet e Teknologjisë së Informacionit, digjitalizimi dhe Ndërkombëtarizim, do të jenë në fokus të Planit afatmesëm, me synim zbatimin e këtyre prioriteteve të qeversisë shqiptare dhe dixhitalizimit të procesit mësimor dhe të të dhënave të institucionit.

- ✓ Rritja e numrit të nxënësve në shkollë dhe shtimi i numrit të vajzave, ka qenë fokusi i fushatës së promovimit të institucionit në tre vitet e fundit.
- ✓ Prioritet në 4 vitet e ardhme, do të jetë procesi i ngritjes së Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, jo vetëm përmes kapacitimit të stafeve përgjegjëse në cikle të plota trajnimi, por edhe aktivitetet e zhvilluara, rastet e identifikuara me rrezik braktisje të shkollës nga nxënësit, si dhe masat e marra.
- ✓ ***Plani i parandalimit të largimit të nxënësve*** do të përfshijë të gjithë periudhën e shkollimit dhe do të mbështetet mbi një strategji specifike te shkollës që lidhet me 5 fushat kryesore: administrative, sociale, personale, pedagogjike dhe kurrikulare, mbështetja e të mësuarit, sigurimi i mbështetjes së vazhdueshme, si dhe të përcaktojë matricën e riskut dhe probabilitetin e braktisjes.

1. Procesi e përgjegjësitë

Plani Afatmesëm u hartua nga grupi për planifikimin dhe monitorimin, kontribut kanë dhënë edhe pjesa më e madhe e mësimdhënësve, përfaqësuesve të Bordit drejtues, senati i shkollës. Edhe konsultimet me prindër, nxënës, biznese dhe patnerë të tjerë kanë ndihmuar për hartimin e një plani afatmesëm që do të ndihmojë shkollën për përmirësimin e vazhduar të cilësisë si edhe plotësimin e kushteve për akreditimin e saj.

Grupi për planifikimin dhe monitorimin

Elona Qehajaj	Drejtore
Fatbardha Sallaku	N/Drejtore
Donald Vogli	N/Drejtor
Alma Caka	Përgjegjëse Njësia e zhvillimit
Edlira Dallo	Përgjegjëse e bazës prodhuese
Silva Gorica	Përgjegjëse e departamentit Hoteleri Turizëm
Driola Karaj	Përgjegjëse e departamentit Teknologji ushqimore
Esmeralda Meta	Përgjegjëse e departamentit të lëndëve të përgjithshme.
Eda Behaj	Sektori financë administrim

Hapat e ndjekur për hartimin e Planit Afatmesëm:

- ✓ Ndarja e detyrave mes grupit të punës;
- ✓ Grumbullimi evidencave brenda shkollës;
- ✓ Grumbullimi i evidencave për analizën e jashtme nga burime si INSTAT, Qarku Tiranë, Drejtoria Rajonale AKPA Tiranë;
- ✓ Takime e diskutime për hartimin e analizës së brëndshme,analizës së jashtme dhe analizës SWOT
- ✓ Evidentimit i vlerave të institucionit dhe shkrimi i Vizionit dhe Misionit;
- ✓ Hartimi i prioriteve dhe objektivave strategjike dhe aktiviteteve përkatëse duke finalizuar draftin përfundimtarë;
- ✓ Konsultimi më grupet e interesit si:këshilli i mësimdhënësve, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve, përfaqësues të bizneseve partnere;
- ✓ Reflektimi në plan i sugjerimeve nga konsultimi me grupet e interesit që konsiderohen me vlerë nga grupi i punës.
- ✓ Plani Afatmesëm miratohet në Bordin e Shkollës.

Hartimi i planit afatmesëm ishte një proces i gjatë pune dhe analize e punës në institucion për procesin mësimor-edukativ, rezultateve të viteve të fundit duke konsideruar edhe faktin e mungesës së infrastrukturës dhe mësimin në kushtet e shtëpisë, faktorë që kanë ndikuar për tre vite punën e institucionit, përgatitjen e nxënësve dhe sidomos aftësimin profesional të tyre dhe komunikimin me bizneset.
Institucioni ka vlerësuar edhe kërkesat e tregut për punonjës të kualifikuar në profile të veçanta dhe do zhvillojë ofertën e tij bazuar në këto kërkesa, duke marrë në konsideratë edhe kushtet, kualifimiket e stafit mësimdhënës, infrastrukturën profesionale dhe kapacitete të tjera.

3. Analiza e gjendjes

Me një kontribut gjithnjë në rritje, turizmi është burim i rëndësishëm i gjenerimit të të ardhurave dhe krijimit të vendeve të punës në ekonomi. Për shkak se turizmi përmbledh në një numër industrish dhe shërbimesh dhe përfshin dimensione sociale, kulturore dhe mjedisore përtej zhvillimit fizik dhe marketingut, turizmi ka potencial të theksuar për të ndikuar në rritjen e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe konkurrueshmërinë e Shqipërisë. Në veçanti, Shqipëria është e pozicionuar strategjikisht për t'i përmbushur pritjet gjithnjë në rritje për një treg të qëndrueshëm turizmi, me orientim nga natyra dhe kultura.
Ndonëse treguesit e viteve të fundit dëshmojnë për një trend pozitiv, të rritjes së numrit të vizitorëve. Në të njëjtën kohë, sektori përballet me kërkesën gjithnjë në rritje ***për personel të kualifikuar dhe shërbime më cilësore.***
Vizioni se "Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare, mbi parime rigoroze që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke e vlerësuar

turizmin si sektor strategjik dhe prioritar të ekonomisë, me ndikim të lartë social dhe komunitar. Rritja e kontributit të turizmit në të ardhurat e përgjithshme të vendit, ***rritja e punësimit në sektorin e turizmit***, përmirësimi i nivelit të jetesës, rritja e shpenzimeve për turizëm, rritja e të ardhurave nga aktivitetet dhe shërbimet turistike, janë disa nga faktorët që ndikojnë ekonominë e vendit.
Ndër fushat kryesore drejtimet strategjike në të cilat fokusohen politikat e turizmit është edhe ***Zhvillimi i burimeve njerëzore*** (përmirësimi i cilësisë së shërbimeve).

3. Analiza e mjedisit të jashtëm

3.1.1. Zhvillimi ekonomik rajonal

Turizmi kulturor, natyror, turizmi i biznesit dhe kongreseve përbën ndërmarrjen më efikase dhe rrugën më të shpejtë drejt zhvillimit lokal ekonomik të Tiranës, duke ofruar turizëm gjithëvjetor, si kryeqyteti i vendit. Kjo arrihet nëse vihet në jetë bashkëpunimi qeveri lokale - komunitet i biznesit - shoqëri civile - komuniteti në përgjithësi. Tirana tashmë është shndërruar në kryeqytet të zhvillimit dhe kulturës, në një qytet ku numri i vizitorëve dhe turistëve rritet çdo ditë, me shifra të konsiderueshme.
Kjo ka bërë që Tirana të jetë një destinacion turistik gjithëvjetor. Ferma, bujtina, hotele, restorantet e shumta, baret, diskotekat, si dhe hotelet e shumta në qendër të Tiranës, shumë prej të cilave brande të njohura botërore, po bëhen më të panjohura për vizitorët nga Rajoni i Ballkanit dhe e gjithë europa. Këto ndryshime shoqërohen me ndryshime sociale dhe ekonomike, me pasoja pozitive. Përballë këtyre transformimeve, rezultatet në fushën e turizmit janë mjaft të shpejta dhe përfshijnë segmente të gjëra të jetës së njerëzve, si punësimi i një numri të madh punonjësish në këtë industri.
Qeveria shqiptare, ka identifikuar sektorin e turizmit, si një nga sektorët parësorë në vend, krahas Bujqësisë dhe Teknologjisë së Informacionit. Pikërisht për të garantuar fuqi punëtore profesionalisht të përgatitur, është e nevojshme përmirësimi i dukshëm i marrëdhënieve shkollë-biznes, ku kryerja e praktikave profesionale të nxënësve në vendin e punës, duhet të jetë prioritet i shkollës. bashkëpunimi shkollë-biznes.



3.1.1. Tregues demografik dhe të tregut të punës

Situata e tregut shqiptar të punës, jap një panoramë të përgjithshme të shkaqeve dhe pasojave me të cilat shoqërohet tregu i punës, duke treguar edhe veçoritë që ekzistojnë për secilën gjini dhe grupmoshë, në mënyrë paraqitjen sa më mirë të dallimeve që aktualisht ekzistojnë ndërmjet tyre. Tashmë është e njohur lidhja që ekzistojnë midis tregut të punës me arsimin, madhësinë e ndërmarrjeve, nivelin e pagave si dhe krahasime me faktor social siç janë grupet e pafavorizuara dhe emigrantët e kthyer në vend.



Në Shqipëri vihet re një koncentrim i madh i bizneseve në zonën Tiranë-Durrës. Përsa i përket lidhjes mes sistemit arsimor dhe punësimit vihet re se ka një mospërputhje mes ofertës dhe kërkesës. Nga krahu i ofertës ka një tejkalim të të diplomuarve në shumicën e fushave të studimeve të larta dhe nga ana tjetër tregu ka mungesa të të diplomuarve në Arsim Profesional në fusha të kërkuara nga tregu i punës. Bizneset shpesh herë nuk gjejnë njerëz të arsimuar në profilet e kërkuara prej tyre. Në një treg konkurrues, punëdhënësit shpesh preferojnë të diplomuarit nga shkollat e Arsimit Profesional por edhe me përvojë pune. Kërkesat e punëdhënësve tre vitet e fundit janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, për fuqi punëtore sidomos në sektorin e hotelerisë dhe të turizmit.

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit për tregun e punës në Shqipëri ishte kthimi i emigrantëve e shkaktuar kryesisht nga pandemia, ku situata e vështirë ekonomike e vendeve pritëse të emigrantëve shqiptarë, bëri që një pjesë e madhe e tyre të kthehen sërish në

vend, duke kërkuar që të përfshiheshin në tregun e punës. Kjo kategori kërkon ndërmarrjen e politikave konkrete, si trajnime profesionale apo dhe konsulenca për këtë kategori që të mund të kenë një integrim sa më të shpejt në tregun e punës.
Fenomen mbizotërues vitet e fundit, është edhe mogracioni, ku një numër i konsiderueshëm njerzish i janë drejtuar Tiranës për një jetë më të mirë dhe për një punë të garantuar

Shkalla e punësimit sipas moshës në vite.

Grupmosha	2017	2018	2019	2020	2021
Gjithsej					
15-29	33.8	38.5	41.2	41.2	41.5
30-64	68.7	70.9	71.8	70.7	70.6
15-64	57.4	59.5	61.2	60.6	60.9
15+	50.3	52.1	53.4	52.5	52.9
Meshkuj					
15-29	38.5	44.7	46.6	46.9	46.6
30-64	77.9	79.3	79.9	78.9	79.4
15-64	64.3	66.7	68.2	67.8	68.2
15+	57.1	59.0	60.1	59.2	59.5
Femra					
15-29	28.3	32.0	35.7	35.3	36.4
30-64	60.0	62.9	64.0	62.8	62.2
15-64	50.3	52.4	54.4	53.6	53.8
15+	43.5	45.3	46.9	46.1	46.4

Sipas të dhënave nga viti në vit përqindja e punësimit është në rritje, rritje ka edhe për moshat mbi 15 vjec. Ritjen më të madhe ke ka grupmosha 15-29 vjec

Norma e papunëisë në vite



Tendence e uljes së papunësisë nga viti në vit është e dukshme për perjudhën 2015- 2022 por edhe këto pesë vitet e fundit. Nga grafikët shohim që 14.1 në vitin 2017 në 11.8 në 2018 dhe ka shkuar në 9.4 në vitin 2022 edhe në vitin 2023 ka pësuar ulje e normës së papunësisë.

Zhvillime politiko ligjore

Vitet e fundit, ka një përmirësim të dukshëm të legjislacionit për AFP. Ministria përgjegjëse për AFP, ka miratuar një sërë aktet nënligjore, rregullore e dokumente të tjera që përmirësojnë punën e institucioneve arsimore. AKPA përgjegjëse për menaxhimin e shkollave të AFP, si dhe AKAFPK po mbështesin shkollat për rezultate me cilësore në punën e tyre.
AKAFPK ka nisur një proces të rëndësishëm në Sigurimin e Cilësisë në arsimin dhe formimin profesional, procesin e akreditimit. Ky proces mbështetet në Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021 "Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional".

Në kuadër të procesit të akreditimit, vetëvlerësimi mbetet një komponent thelbësor për një sistem efikas të sigurimit të cilësisë që i paraprin akreditimit. Si hapi i parë drejt sigurimit të cilësisë, procesi i vetëvlerësimit , duhet të ketë përfunduar përpara se shkolla të nisë aplikimin për procesin e akreditimit në AKAFPK.

Ligji 15/2017 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

Ligji 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Ligji 56/2015 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Ligji 10296, DATË 8.7.2010 "PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN", I NDRYSHUAR.

Ligji NR. 23/2018 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 247, DATË 4.3.2010, "PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE"".

Kodi i Procedurave Administrative te Republikës së Shqiperise

Ligj NR.8503, DATË 30.6.1999 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR DOKUMENTET ZYRTARE"

Ligji NR. 9154, DATË 6.11.2002 "PËR ARKIVAT"

Ligji 15/2019 "PËR NXITJEN PËR PUNËSIM"

Urdhëri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.128 datë 6.7.2021 "*Për miratimin e "Rregullores për Standartet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesëve të Arsimit dhe Formimit Profesiona*l"

Udhëzim NR. 14 DATË 27.05.2021

Udhëzim NR. 14 DATË 28.07.2021

Udhëzim NR. 28 DATË 30.07.2018 "MBI KRITERET PËR PJESËMARRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DREJTUES TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL".

Vendim NR, 4, DATË 19.6.2017 PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES SË NJEHSUAR TË PUNËS ME DOKUMENTET NË AUTORITETET PUBLIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Urdhër NR. 191, DATË 08.09.2016 "PËR NGRITJEN E SISTEMIT TË GJURMIMIT PËR NXËNËSIT E DIPLOMUAR DHE KURSANTËT E OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL"

Udhëzim NR.15, DATË 26.4.2019 PËR "ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL"

Rregullore e PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË BIZNES (U 220, DATE 16.09.2020)

Udhëzim NR 13 DATË 13.04.2022 PËR "MËSUESIN NDIHMËS DHE NGRITJEN E FUNKSIONIMIN E KOMISONIT PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PROFESIONAL.

Udhëzim Nr 26,datë 22.09.2022 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR .28 DATË 14.10.2029 "PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PROFESIONAL"

3.1.2. Arsimi e formimi në rajon

Në Tiranë aktualisht kryejnë veprimtarinë e tyre 4 shkolla të AP dhe 3 qendra të Formimit Profesional, të cilat kualifikojnë një numër të konsiderueshëm nxënësish edhe në sektorin e mikpritjes, të gatshëm për tu përfshirë në tregun e punës. Por nevojat për këta punonjës, janë shumë më të mëdha për rajonin e Tiranës, prandaj kërkohet rritje e numrit të nxënësve që duhet të studiojnë në shkollat dhe qendrat e AFP në Tiranë. Nga ana tjetër, emigracioni dhe lëvizja e popullsisë, ka bërë që numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare, ka ardhur duke u ulur dhe rrjedhimisht edhe rregjistrimet në shkollat e AP.

Numri i nxënësve dhe studentëve të regjistruar në arsim 2017-2022

Niveli ISCED	**Viti shkollor / akademik**	**2017-18**	**2018-19**	**2019-20**	**2020-21**	**2021-22**
1 - 8	**Gjithsej:**	691,628	678,867	644,209	626,261	608,952
1	Në fillore	170,861	167,104	162,170	158,528	154,140
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	148,810	139,426	132,709	127,958	123,998
3	Në arsimin e mesëm:	120,062	116,646	109,533	107,989	103,467
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	99,457	95,359	89,869	88,965	85,188
	Në Profesional	20,605	21,289	19,664	19,024	18,279
5-8	Në arsimin e lartë:	131,833	139,043	130,264	123,797	123,880

Të rregjistruar në arsim





3.2. Analiza e brendshme (për 4 vitet e fundit)

Përmes kësaj analize synohet të shqyrtohen të gjithë faktorët në mjedisin e brendshëm që mund të kenë një ndikim tek shkolla dhe progresi i saj. Konkretisht do të analizohen faktorë të tillë si: performanca e nxënësve në tregun e punës dhe në shkollë, performanca e stafit të shkollës, infrastruktura, bashkëpunimet e shkollës me sektorin privat, bashkëpunimi me projekte etj. Në përfundim të kësaj analize synohet të identifikohen pikat forta dhe kompetencat e shkollës në mënyrë që këto të mund të përdoren për të fuqizuar pozicionin e saj në treg. Po ashtu nga kjo analizë synohet të identifikohen pikat e dobëta të cilat mund të ngadalësojnë rritjen dhe zhvillimin e shkollës.

3.2.1 Performanca e nxënësve në tregun e punës

Performanca e nxënësve të diplomuar/ certifikuar për të gjitha kualifikimet për të dy drejtimet që ofron shkolla edhe sipas gjinisë.

Numri i nxënësve të certifikuar në dy vitet e fundit: (Niveli I+II+III): 1325
Numri i nxënësve të diplomuar: 1320

% e nxënësve të punësuar pas përfundimit ë shkollës:

- ✓ Hoteleri Turizëm mbi 80 %;
- ✓ Teknologji Ushqimore 11- 13 %

Vajza të punësuara: 5- 8 %

Numri i nxënësve që nuk punojnë: 20-24 %

Nxënës të vëtëpunësuar: 2 -5 %

Numri i nxënësve që vazhduan studimet e larta: 5-10 %

Të punësuar jashtë vendit: 5-6 %

Performanca e nxënësve të diplomuar për maturantët për të dy drejtimet që ofron shkolla



Nga viti në vit është rritur numri i nxënësve të punësuar në krahasim me numrin e përgjithshëm të nxënësve të diplomuar. Rezultatet e grafukut më lart janë për maturantët në bazë të procesit të gjurmimit që zhvillohet cdo vit në shkollë.
Në drejtimin Hoteleri – Turizëm numri i nxënësve të punësuar nga viti në vit është më i madh se në drejtimin teknologji ushqimore, por numri i nxënësve që ndjekin studimet e larta në drejtimin teknologji ushqimore është më i madh krahasuar drejtimin Hoteleri – Turizëm.
Nga rezultatet e gjurmimit nxënësit e drejtimit Hoteleri – Turizëm kanë përqindjen më të madhe të të punësuarve brenda kualifikimit. Për kualifikimin teknologji ushqimore numri i nxënësve që punësohen janë jashtë profilit të studimit.



3.2.2 Nxënës nga regjistrimi në diplomim/certifikim



Nxënës nga rregjistrimi në diplomim

		2016-2020	2017-2021	2018-2022	2019-2023
Regjistruar	Gjithsej	244	261	287	290
	Femra	63	60	82	77
Diplomuar	Gjithsej	174	182	242	258
	Femra	53	56.	78.0	69

Nga të dhenat tendenca është në rritje të numrit të nxënësve të diplomuar krahasuar me regjistrimet. Për regjitrimet në 2017 dhe diplomimet në 2021 është perjudha që ka patur më shumë largime. Largimet kanë qenë për arsye të ndryshme si emigracioni apo nxënës që kanë rezultuar ngelës dhe janë diplomuat një vit më vonë.

Regjistrimet në vite dhe regjistrimet për herë të parë.

Viti	Regjistrime		Regjistrime per here te pare	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2018-2019	920	275	300	85
2019-2020	949	276	313	81
2020-2021	935	248	211	34
2021-2022	897	218	201	37
2022-2023	809	191	230	58



Nga grafiku duket që ka një ulje të numrit të nxënësve të regjistruar edhe për herë të parë. Shkaqet janë disa por shkaku kryesor është ulja e numrit të nxënësve në shkollat 9 vjecare nga të cilat vjnë kryesisht nxënësit e shkollës Hoteleri- Turizëm. Kalimi i shkollës në turnin e dytë në shkolla të tjera gjatë përiudhës 2019-2023







Nxënës të regjistruar/ Femra të regjistruara/Nxënës të larguar/Femra të larguara

	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Nxënës të regjistruar	300	313	211	201
Femra të regjistruara	85	81	34	37
Nxënës të larguar	13	23	4	19
Femra të larguara	3	4	0	2



Sic vihet re nga të dhënat në grafikët për numrin e regjistrimeve ka një ulje të numtit nxënësve por edhe të regjistrimeve për herë të parë. Ulja më e theksuar ka qenë viti shkollor 2020-2021, ka vazhduar përsëri ulja e regjistrimeve por me një përqindje më të vogël në vitin 2021-2022, ndërsa për vitin 2022-2023 ka patur rritje të numrit të regjistrimeve jo vetëm në të numrit të përgjithshëm të regjistrimeve por edhe të numërit të vajzave. Rritja e numrit të nxënësve të regjistruar ka ardhur si pasojë përmirësimit të promovimit të ofertës mësimore në shkollat 9 vjecate por dhe me ndihmën e projekteve për vajzat financuar nga OEAD, për të rritur numrin e vajzave në shkollë.
Një problem tjetër është dhe rritja e numrit të nxënësve të larguar, këta nxënës largohen kryesisht në emigracion shkolla bën përpjekjet maksimale si bashkëbisedime me mësuesin kujdestar, drejtorinë, psikologen për të ulur sa më shumë numrin e nxënësve të larguar.



Siç shihet nga tabela numri i mungesave është në rritje por për vitin shkollor 2023-2024 pati një ulje të numrit të mungesave për nxënës nga 22 në vitin shkollor 2022-2023 në 18.6 nëvitin 2023-2024
Shkaqet e mungesave mendojmë që janë:

-Ardhja në shkollë e shumicës së nxënësve me mjete transporti, bën që në disa raste të mos jenë të përpiktë me ardhjen në orarin e caktuar, duke bërë që të humbin orën e parë të mësimit
-Vonesat e nxënësve në pushimin e madh, duke u ushqyer në "fast food" bën që në disa raste të humbasin orarin e fillimit të orës pas pushimeve të gjata.
-Një numër nxënësish janë të punësuar part-time(pasdite deri vonë) dhe kjo bën që ata në raste humbasin orët e para të mësimit
- mësimi me dy turne në shkolla të ndryshme gjatë përiudhes 2020- 2023



Viti	vlerë		Matura	
	Kal	Note matura	Kal	Note matura
2018-2019	91%	6.0	85%	6.2
2019-2020	100%	6.4	98%	6.8
2020-2021	97%	6.3	77%	6.0
2021-2022	95%	6.1	93%	7.0





Mesatarja totale e rezultateve vjetore krahasuar me mesataren totale të maturës shtetërore ndër vite (për të gjitha lëndët së bashku) është më e ulët. Në vitet 2019-2020, 2021-2022 mesatarja gjatë vitit shkollor është 0.1 më e lartë krahasuar me maturën shtetërore. Në vitin 2018 -

2019 mesatarja është 0.2 më e ulët gjatë vitit shkollor krahasuar me mesataren në maturën shtetërore, ndërsa në vitin 2019-2020 mesatarja e rezultatve të lëndëve në shkollë është 0.4 më e ulët krahasuar me masataren totale të lëndëve në maturë shtetërore,

Në vitin 2020 -2021 mesatarja është 0.3 më e ulët gjatë vitit shkollor krahasuar me mesataren në maturën shtetërore, ndërsa në vitin 2021-2022 mesatarja e rezultatve të lëndëve në shkollë është 0.9 më e ulët krahasuar me masataren totale të lëndëve në maturë shtetërore

Kjo diferencë nuk është e konsiderueshme por duhet të konsiderohet për të motivuar nxënësit më shumë me nota më të gjitha lëndët e zhvilluara në shkollë. Rezultatet tregojnë se vlerësimi i mësueve në shkollë ka qënë objektiv.

Rezultatet për katër Maturës krahasuese vite të Shtetërore

Viti Shkollor	Letërsi		Anglisht		Matematikë		Teori Profesionale	
	% Kal	Nota Mesatare	% Kal	Nota Mesatare	% Kal	Nota Mesatare	% Kal	Nota Mesatare
2017-2018	96	6.5	99	7. 8	68	5. 2	98	5.6
2018-2019	100	6.7	98	6. 7	85	5.5	96	5.8
2019-2020	100	6.7	100	7. 4	98	6.3	100	6.8
2020-2021	96	5.8	99	7. 5	77	4.9	91. 5	5.7
2021-2022	100	7.3	99.5	7. 2	93	6	99.5	7
2022-2023	99	6. 2	98	7	93	5.3	100	6.7


Kalueshmëria në provimet e MATURËS SHTETËRORE
600%
500%
400%
300%
200%
100%
0%
99%
100%
96%
100%
100%
93%
93%
77%
98%
85%
98%
99%
99%
100%
98%
100%
100%
99%
92%
100%
96%
Letersi
Matematikë
Anglisht
T.profesioni
2018-2019
2019-2020
2020-2021
2021-2022
2022-2023

Cilësia në provimet e niveleve teori dhe praktikë profesionale



Sipas grafikut dhe tabelës më poshtë duket qartë që pjesa më e madhe në provimet për të tre nivelet ka një kaluehmëri 100% .Kalueshmëria me e ulët është kryesisht në drejtimin teknologji ushqimore në vite dhe nivele të ndryshne. Por per vitin 2022-2023 kalueshmëria ka qenë 100%

Cilesia ne provimet teori dhe praktike profesionalesipas drejtimeve të shkollës.

		Niveli II KSHK		NIVELI III KSHK		NIVELI IV KSHK	
		TU	HT	TU	HT	TU	HT
2018-2019	Praktike	98%	99%	83%	100%	88%	100%
	Teori	97%	97%	100%	92%		
2019-2020	Praktike	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	Teori	100%	100%	100%	100%		
2020-2021	Praktike	99%	98%	100%	94%	97%	99%

	Teori	100%	99%	99%	97%		
2021-2022	Praktike	94%	92%	96%	100%	96%	99%
	Teori	94%	93%	96%	100%		
2022-2023	Praktike	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	Teori	100%	100%	100%	100%		

Nota mesatare në provimet e niveleve



Nga të dhënat e grafikëve vërehet që nota mesatare është më e ulët në drejtimin teknologji ushqimore në vite të ndryshme dhe nivele të ndryshme . Vlen të theksohet që, nga analizat vjetore për ndryshimet në notë midis vlerësimit përfundimtar dhe grup lëndëve apo grup moduleve që janë në provim, diferenca midis tyre gjithmonë më e vogël se 15%

Përbërja sociale e nxënësve.



3.2.3 *Stafi drejtues, mësimor e mbështetës*



Të gjithë mësimdhënësit e kulturës profesionale janë të trajnuar në Bazat e didaktikës gjatë viteve të punës si mësimdhënës në shkollë. Një numër i konsiderueshëm është trajnuar nga projekte të ndryshme si OEAD, austriak K-Kontakt si dhe projekte të tjera të huaja. Ata janë trajnere, autore materialesh mësimore dhe tekstesh për nxënësit, anëtare të grupeve të punës për hartimin e dokumenteve kurrikularë, ndërsa mësimdhënësit e tjerë janë në process trajnimi të vazhdueshëm. Të gjithë mësimdhënësit që vijnë nga universitete jo mësimdhënësie, kanbë kryer trajnimin didaktik 24 ditor, me mbështetjen e GIZ dhe AKAFPK, ndërsa mësimdhënësit e rinj e kanë filluar këtë trajnim.
Mësimdhënësit e moduleve profesionale vijnë nga përvoja të gjata pune në biznes dhe shumë prej tyre kanë qenë edhe ish nxënës pranë shkollës. Ata zotërojnë aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe janë shumë të angazhuar në trajnimin profesional të nxënësve.
Në shkollën tonë mësimdhënësit e teorisë profesionale janë kryesisht mësimdhënës me përvojë të gjatë pune, por për shkak të rritjes së numrit të nxënësve në shkollë dhe hapjes së profileve të reja, numri i mësimdhënësve të rinj, është rritur. Njësia e zhvillimit, departamentet lëndore dhe drejtoria e shkollës ka bërë përpjekje për trajnimin profesional të tyre me trajnime të brendshme por edhe me ekspertë të jashtëm.

Gjithashtu ka patur përpjekje edhe për vetëtrajnime, duke ndjekur trajnime që ofrohen nga organizata të akredituara për trajnime. Ka mësimdhënës të cilët vazhdimisht ndjekin edhe trajnime në nivel europian dhe certifikohen për trajnimet e kryera.
Mësimdhënësit e kulturës së përgjithme vijnë të gjithë nga Universitete mësimdhënësie, ata përgjithësisht zotërojnë konceptet shkencore të lëndës dhe janë aktivë në orët e mësimit, duke konsideruar nivelin e arritjeve të nxënësve tanë. Janë hartues të mire të planeve lëndore, të planeve ditore dhe janë trajnuar nga institucioni edhe për mënyrat e vlerësimit në Kulturën e Përgjithshme.
Ngritja e Njësisë së Zhvillimit, do t'i paraprijë punës për trajnime të vazhdueshme dhe bashkëkohore të stafit. Duhet theksuar se gjatë pandemisë, janë kryer nga mësimdhënësit edhe trajnime për metodat e mësimdhënie online.
Drejtoria e shkollës gjithashtu ka planifikuar buxhetin dhe ka realizuar trajnim për të gjithë stafin mësimdhënës, brenda institucionit me eksperte të fushës për të dy kategoritë e mësimdhënësve: Kulturë e Përgjithshme dhe Kulturë Profesionale. Këto trajnime janë të parashikuara edhe për vitet në vijim.
Mësimdhënësit përgatiten rregullisht me Plane Ditore, ku përshkruhen me detaje të gjitha fazat e orës mësimore. Çdo ditë përgatitja ditore e tyre mund të monitorohet nga drejtuesit e shkollës, pasi ajo dërgohet me E-Mailin zyrtar të institucionit, të paktën prej tre vitesh. Ka modele të përgatitjes së tyre dhe performancës në mësimdhënie për tu ndjekur nga të gjithë mësimdhënësit e rinj, apo mësimdhënësit që nuk kanë të njëjtën performancë.

Numri i mësimdhënësve sipas kategorisë



Personeli mbështetës:

Sektori financës zotëron aftësitë për të monitoruar, kontrolluar dhe zbatuar të gjitha ligjet, udhëzimet dhe urdhërat që jepen nga institucionet qëndrore për menaxhimin financiar.
Sekretaria është drejtuar me shumë kompetencë, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha afatet kohore për hedhjen në Amëz të rezultateve vjetore, të Maturës Shtetërore apo rezultatet e Sesionit të II. Amzat e shkollës që janë dokumenti më i rëndësishëm, janë plotësuar vetëm nga sekretaria mësimore e institucionit. Sekretaria ka lëshuar dokumente zyrtare për të gjithë të interesuarit në afate kohore dhe pa asnjë gabim. Dokumentacioni shkollor ruhet në kushte të sigurta.
Shërbimi i rojeve kryen me korrektësi dhe kompetencë detyrat e tij dhe raporton rregullisht për çdo problematikë që ka lidhje me sigurinë në institucion.
Mirëmbajtësi ka garantuar maksimalisht kushtet e mirëfunksionimit të institucionit dhe veçanërisht të reparteve të praktikave profesionale, ku puna e tij është shumë e rëndësishme.
Shërbimi i pastrimit ka kryer shumë mirë detyrat e përcaktuara edhe në kushtet e zhvillimit të mësimit në dy godina dhe me shumë turne.
Shërbimi psikologjik ka qenë aktiv, duke evidentuar rastet që kërjonë mbështetje dhe ndërhyrje, dukëe punuar me rastet, me mësimdhënësit kujdestarë të tyre si dhe duke komunikuar dhe u konsultuar vazhdimisht me prindërit.

3.2.1. Infrastruktura

a) Të dhëna të përgjithshme

Godina e shkollës është ndërtuar në vitin 1959 dhe është rikonstruktuar pjesërisht në vitin 2007 – 2009. Në vitin 2019, shkollës i janë shtuar dy godina të reja, me 10 - klasa mësimore dhe disa reparte të praktikave profesionale, investime të qeverisë shqiptare. Godina ka tri kate, ku në katin e dytë dhe të parë janë të vendosura laboratoret, FU, laborator TIK, kabinetet profesionale, biblioteka e shkollës, dhoma e qeverisë së nxënësve, dhoma e psikologes, biblioteka, salla e konferencave, zyra të administratës, reparte të praktikave profesionale, palestra etj. Në këto ambjente aktualisht zhvillohet mësim normalisht. Godina është rikonstruktuar vitet e fundit dhe ka dyer e dritare të reja,
Në oborrin e jashtëm funksionon Baza Prodhuese me disa reparte të praktive profesionale:
3 Kuzhina
3 Restorante
1 Bar

1 Pastiçeri
1 Lavanteri
3 Dhoma Zhveshje
1 Repart Prodhim pijesh dhe përpunim fruta perime.
1 Repart Qumështi (i montuar pjesërisht)
1 Repart Përpunim Brumi

Në kushte normale: Ka 32 klasa mësimore, 18 dhoma mësimore, 1 laborator biologjie, 1 laborator fizike, 1 laborator të kryerjes së analizave të produkteve ushqimore, 2 laborator TIK, 2 zyra mësimore, 3 recepsion, 3 restorante dhe 1 bar (në funksion të procesit mësimor), 4 kuzhina (në shërbim të procesit mësimor), 1 repart për përpunimin e brumit, 1 repart pastiçerie, palestër, terren sportiv dhe anekse të tjera funksionale (magazinë, arkivë etj).
Godina është e pajisur me sistem ngrohje.
Godina dhe oborri i saj kanë ndriçim të bollshëm.
Shkolla ofron ambjente shlodhese dhe të gjelbëruara rreth saj me lule dhe të kuruara estetikisht.

- ✓ Psikologia e shkollës e realizon veprimtarinë e saj në zyrën e psikologes (këshillim dhe realizim të aktiviteteve të tjera).
- ✓ Shkolla ofron infrastrukturën e duhur për fëmijë me aftësi të kufizuar.
- ✓ Shkolla ka bashkëpunime të vazhdueshme me organizata të tjera, donatorë të huaj që mbështesin AP në Shqipëri, qendra trajnimesh profesionale, organizata kulturore, sportive dhe artistike si dhe është e hapur për bashkëpunime të reja. Eshtë anëtare e AEHT, Shoqata e shkollave Europiane të Hotelerisë. Në vitin 2019-2020 është bërë pjesë e rrjetit të shkollës së ekselencës për të nxënët në vendin e punës dhe aktualisht është anëtare e këtij rrjeti europian – ETF.

<u>Sisteme TIK që përdoren dhe aksesi në internet</u>

Shkolla aktualisht ka laborator dy laboratorë TIK.

Numri i kompjuterave në laboratorin TIK - 25
Numri i laptop 50 copë
Printer - 5
Projektor - 7
Laborator i gjuhëve të huaja i paisur me 25 Ipad dhe 25 kufje.

Oborri dhe mjediset sportive

I gjithë territori i shkollës është 4600 m^2 ndërsa vetë godina 2543 m^2.
ka 1 palestër e cila është rikonstruktuar. Në oborrin e jashtëm të saj, shkolla ka një terren sportive edhe ky i rikonstruktuar..

Mobilimi dhe mjete mësimore në klasa

Klasat mësimore janë të mobiluara shumë mirë, me banga dhe karrige dhe ato mirëmbahen me shumë kujdes nga nxënësit nën kujdesin e mësimdhënësit kujdestar.
Gjithashtu në shkollë të gjitha repartet e praktikave profesionale Hoteleri janë të pajisura me mjete pune dhe pajisje të cilat i shërbejnë aftësimit praktik të nxënësve.
Në drejtimin mësimor "Teknologji Ushqimore", është reparti i prodhimit të produkteve të brumit, prodhimit të pijeve dhe përpunimit të fruta perimeve, dhe pjesërisht në punë reparti i përpunimit të qumështit.
Shkolla ofron bazë materiale të konsiderueshme edhe për mësimin teorik.
Sektori i financës kujdeset që shkolla të ketë furnizim ritmik me lëndë të para dhe materiale që i shërbejnë procesit prakti që kryhet në shkollë, por edhe kujdesit për higjienën e pastërtinë në institucion.
Laboratorët, pajisjet, mjetet e punës (për lëndët e përgjithshme dhe lëndë/module profesionale)

Nr	**Ambjenti**	**Sipërfaqe**
1	Biblioteka	50 m^2
2	Laboratori i kimisë	41 m^2
3	Laboratori i analizave	41 m^2
4	Laboratori i biologjisë	41 m^2
5	Laboratori TIK	41 m^2
6	Laborator fizike	41 m^2
7	Qeveria e Nxënësve	41 m^2

Mjedise të përbashkëta - bibloteka

Shkolla është e pajisur me bibliotekë të pasur me 1856 tituj librash dhe tituj tekstesh mësimore të kulturës së përgjithshme të ofruara nga shtëpitë botuese dhe të kulturës profesionale në formën e materialeve mësimore, por kohët e fundit nuk ka patur rinovim apo shtim me tituj të rinj, për mungese fondesh, apo planifikim për tituj nga fondi i Bashkisë Tiranë.

Mjedise për administratën

Mjediset për administratën ndodhen në godinën e dëmtuar nga tërmeti dhe puna e administratës është e vështirë për tu realizuar në kushte normale që prej tre vitesh.
Shkolla ka 8 zyra administrate (1 drejtori, 2 n/drejtori, 1 sekretari, 2 zyrë finance, 1 Njësia zhvillimore, 1 departamentet).

3.2.4 Bashkëpunimi me sektorin privat

Numër biznesesh sipas numrit të praktikantëve

Shkolla ka një bashkëpunim shumë të mirë me bizneset e fushës së Hotelerisë dhe të Turizmit si dhe në fushën e furrave të bukës dhe pastiçerisë. Vitet e fundit numri i biznesve partnere shkoi rreth 283 ku 90 % e nxënësve në total dhe 100% e nxënësve të drejtimit "Hoteleri Turizëm" dhe "Përpunim brumi", kryen praktika profesionale në biznes.
Në fushën e Hotelerisë vlen të theksohet që bizneset partnere janë biznese të njohura kryesisht hotele me 4 dhe 5 yje si dhe restorante shumë cilësore, me një bashkëpunim të qëndrueshëm përgjatë viteve, si dhe pothuajse të gjitha furrat e bukës dhe pastiçerisë në Tiranë, ku realizojnë praktikat nxënësit e profilit "Përpunim Brumi". Numri i bizneseve partnere në vitin 2023, arriti në 283.
Në konsultime të vazhdueshme me biznesin, në takimet në Bordin drejtues apo aktivitete të përbashkëta si dhe në tryeza me biznesin, janë bërë propozime për një ofertë të larmishme nga shkolla, për të plotësuar sa më mirë dhe cilësisht, kërkesat e tyre për punionjës të kualifikuar. Mund të përmendim faktik e kërkesës së bizneseve të furrave të bukës dhe të pastiçerisë për përfshirjen në kurrikulën e profilit "Përpunim brumi" të orëve lidhur me aftësimin profesional të nxënësve në sektorin e pastiçerisë së furrës. Hapja e profileve të reja "Shërbime të udhëtimit dhe të turizmit" në vitin shkollor 2021-2022-2023, është realizuar gjithashtu në konsultim me sektorin e biznesit, duke ofruar si shkollë pothuajse të gjitha profilet e Drejtimit mësimor "Hoteleri-Turizëm"

Analizë e nxënësve praktikantë në raport



Numri i nxënësve që kryejnë praktika profesionale gjatë vitit shkollor është i konsiderueshëm, për shkak të profileve që ofron shkolla jonë.
Në drejtimin mësimor "Hoteleri-Turizëm", që është edhe drejtimi më i kërkuar nga tregu i punës aktualisht, kryejnë praktika profesionale gjithëvjetore nxënësit e profilit "Kuzhinë-pastiçeri" , " Restorant", "Recepsion" 2 ditë në javë të detyruara nga kurrikula shkollore. Gjatë këtyre ditëvë nxënësit monitorohen nga mësimdhënësit e moduleve profesionale sipas profileve. Në Hoteleri bashkëpunimi me bizneset është shumë i mirë, jo vetëm për praktika profesionale por edhe për shkëmbime përvojash, për trajnime mësimdhënësish në biznes apo aktivitete të përbashkëta.
Në drejtimin tjetër mësimor, kemi probleme për realizimin e praktikave në biznes (përveç profilit përpunim brumi), pasi këto biznese janë shumë hezituese, për shkak të kushteve higjieno-sanitare që kërkon Industria Ushqimore dhe rrezikshmërisë që paraqesin linjat e prodhimit.

Vlen të përmenden disa biznese në fushën e Hotelerisë dhe të Turizmit, por edhe të Përpunim Brumit, që mbështesin shkollën prej shumë vitesh dhe partneriteti ka një fushë të gjerë veprimi: praktika të nxënësve, trajnime mësimdhënësish, aktivitete profesionale të përbashkëta, vlerësim i nxënësve nga mjeshtra të biznesit, orë mësimi nga mjeshtra të biznesit etj.

1. Hotel Mondial
2. Hotel Maritim Plaza
3. Tirana International Hotel
4. Hotel Rogner
5. Hotel Diplomat
6. Prestige Resort
7. Furrë buke Durrësi
8. Le Bon
9. Furrë buke Ismailaj
10. Furrë buke Someg etj

Fushat kryesore të ndërhyrjeve nga ndërmarrjet partnere janë:

- *Ofrimi i përbashkët i ofertës përmes praktikave në ndërmarrjet partnere*
- *Sponsorizimi për nxënësit për praktikat profesionale apo pjesëmarrje në konkurse të ndryshme*
- *Trajnimi i mësuesve sipas standardeve të industrisë*
- *Dizajnimi dhe diversifikimi i ofertës së AP-së përmes tryezave të strukturuara me ofrues të AF dhe Ndërmarrjet që punojnë drejt vlerësimit të kërkesës për aftësi dhe përmirësimit të ofertës së ardhshme akademike*
- *Bashkëdrejtimi i shkollës si pjesë e Bordeve Drejtuese.*

3.2.5 Rezulate nga vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi i institucionit, është një process që po ndosh prej tre vitesh. Në vitin e parë u realizua procesi i vetëvlerësimit për të 5 fushat, ndersa në vitin e dytë dhe të tretë, për shkak të tërmetit dhe pandemise, është realizuar vetëvlerësimi vetëm i një fushe. Sipas udhëzimeve nga AKAFPK procesi është zhvilluar në të pesë fushat.
Më poshtë raportet e vetëvlerësimit për dy vitet e fundit.



Procesi i vetëvlerësimit ka filluar në vitin shkollor 2018-2019 ku janë vetëvlerësuar 5 fushat e cilësisë për vitin shkollor 2017-2018.Procesi ka vijuar duke realizuar vetëvlerësimin për 1 fusha për vitin shkollor 2018-2019 dhe 1 fushë për vitin shkollor 2019-2020 dhe përsëri për të gjitha fushat për vitin shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022.
Mbështetur në pikat e dobëta të evidentuara çdo vit janë lënë rekomandimet përkatëse dhe janë marrë masat për përmirësim.

Aktivitetet e planifikuara për përmirësim janë përfshirë në planet vjetore të shkollës, planet e ekipeve lëndore dhe departamenteve dhe për secilin rekomandim të lënë për vitin shkollor 2021-2022 është përgatitur instrumenti i përmirësimit të cilësisë.

Bazuar në rezultatet e procesi të vetëvlerësimit ka patur një rritje të vogël por të qëndrueshme.Nga viti në vit është hartuar dhe zbatuar plani i përmirësimit të cilësisë ku është përfshirë në planin vjetor të vitit 2024-2025

3.2.7.Grupet e interesit dhe partner të brendshëm e të jashtëm.

a. Komuniteti i biznesit (Shtojca 1)

Shkolla e konsideron bashkëpunimin me biznesin si një komponet të rëndësishëm, prandaj ka krijuar lidhje të forta e të qëndrueshme me biznese apo institucione të zonës duke ndarë qëllimet e vlerat dhe duke punuar së bashku me to për të krijuar një mjedis të përgjegjshëm dhe inovativ për përgatitjen e nxënësve për tregun e punës. Aktualisht shkolla ka 283 biznese partnere me Marrëveshje Bashkëpunimi të nënëshkruara dhe gjatë vitit shkollor 2022-2023 kanë realizuar praktikën profesionale në biznes 90% e nxënësve.

b.Komuniteti i prindërve

Bashkëpunimi i shkollës me prindërit mbështetet ne Udhëzimin Nr 14 data 28.05.2021. Janë të ngritur dhe funksionojnë Këshilli I Prindërve të shkollës dhe Këshillat e Prindërve të klasës. Drejtoria e shkollës bën përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës. Mësimdhënësit kujdestarë dhe drejtoria e shkollës mban prindërit të informuar për arritjet e nxënësve ,arritjet e shkollës dhe problematikat e ndryshme nëpërmjet takimeve të realizuara me Këshillin e Prindërve dhe takimeve periodike të realizuara nga mësimdhënësit kujdestar me prindërit e klasës.

Gjithashtu shkolla bën përpjekje të vazhdueshme për të bashkëpunuar me prindër të nxënësve të klasës së 9-të duke i ftuar ato në veprimtaritë promovuese që shkolla realizon si psh “Dita e dyerve të Hapura “, por edhe duke i takuar në shkollat 9 vjecare ku fëmijët e tyre studiojnë.

c. Qeveria e nxënësve

Drejtoria e shkollës bashkëpunon me Qeverinë e Nxënësve sipas udhëzimeve në fuqi.

Qeveria e Nxënësve ka përfaqësuesin e saj në Bordin e Shkollës nëpërmjet të cilit mbahet e informuar mbi aktivitetet,veprimtarite,arritjet e nxënësve dhe problematikat e ndryshme dhe gjithashtu është zëri i të gjithë nxënësve për ankesat apo dhe sugjerimet për përmirësimin e shkollës. Drejtoria e shkollës me qëllim matjen e kënaqësisë së nxënësve realizon cdo vit pyetësorë me nxënësit me kamponim dhe gjithashtu ka krijuar këndin e ankesave.

d. Këshilli i mësimdhënësve

Veprimtaria e Këshillit të Mësimdhënësve mbështetet tek legjislacioni në fuqi. Këshilli i mësimdhënësve ka përfaqësuesin e zgjedhur prej tyre ne Bordin e shkollës. Drejtoria e shkollës realizion në mënyrë të vazhdueshme anketa dhe pyetësore më mësimdhënës me qëllim matjen e kënaqësisë së tyre duke evidentuar problematika apo ankesa me qëllim përmirësimin e punës.

e. Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë është një faktor i rëndësishëm i pushtetit vendor, i cili mbështet vazhdimisht shkollën për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për promovimin e shkollës, miratimin e bursave të nxënësve sipas kategorive përfituese, menaxhimin e konviktit dhe mirëmbajtjen e tij duke siguruar kushte komode për akomodimin e tyre.
Shkolla informon Bashkinë për arritjet e nxënësve duke e bërë pjesë të aktiviteteve të ndryshme që realizohen në shkollë dhe jashtë saj sic është “Dita e Dyerve të Hapura”, “Panairi I Praktikave Profesionale” etj.Gjithashtu shkolla merr pjesë në të gjitha aktivitetet ku ftohet nga Bashkia sic janë panairet e ndryshme etj.

f. Zyra Rajonale Vendore e Punës(AKPA Tiranë)

Zyra Rajonale Vendore e Punës mbështet shkollën për orientimin e nxënësve gjatë klasës së 13-të për tregun e punës dhe mundësitë e punësimit si dhe i rregjistron ato si punëkërkues. Gjithashtu kjo drejtori bashkëpunon dhe mbështet shkollën me të dhënat për tregun dhe për promovimin e saj në komunitet. Një përfaqësues nga kjo drejtori është pjesë e Bordit të shkollës.

g. Këshilli i Qarkut Tiranë

Një përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Tiranë është anëtar i Bordit të shkollës. Nëpërmjet tij shkolla shpërndan informacion mbi ofertën, bashkëpunimet,arritjet dhe punësimin e nxënësve.

h. Bashkëpunimi me donatorë dhe OJF

Shkolla bashkëpunon me donator, OJF me qëllim sjelljen e finacimeve të nevojshmë për mundësi trajnimi për nxënësit e mësimdhënësit, blerjen e paisjeve të reja etj, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë. Shkolla ka bashkëpunuar me OEAD e cila financaur projekte me aspekte gjinore, për përfshirjen e vajzave dhe promovimin e shkollës, gjithashtu ky project ka financuar edhe kabinetin e bar-restorantit.

i.Partnerë të AFP në shkallë kombëtare:

Shkolla ka të identifikuara të gjitha shkollat profesionale të Shqipërisë të cilat ofrojnë të njëjta kualifikime me disa prej të cilave ka krijuar partneritete. Me shkollën e mesme Kamës janë zhvilluar projekte Erasmus në kuadër të projektit VET to VET

j.Partnerë të AFP në shkallë kombëtare:

Shkolla ka bashkëpunim edhe me shkolla të AFP-së në nivel ndërkombëtar,bashkëpunime të vendosura në kuadër të projektit Erasmus+ me shkollat: Profesionale Kamës.

k. Zyra Vendore Arsimore dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

Shkolla bashkëpunon me të dyja institucionet ,por kryesisht me ZVA-Tiranë për:

-Punësimin e mësimdhënësve të lëndëve të përgjithshme nëpërmjet portalit "Mësimdhënës për Shqipërinë".

-Maturën shtetërore.

-Përzgjedhjen dhe shpërndarjen e teksteve për lëndët e kulturës së përgjithshme.

-Lejen për promovimin e shkollës tek nxënësit e klasave të 9-ta

3.2.8 Analiza e arritjeve të objektivave strategjikë të strategjisë së mëparshme:

2. Arritja e objektivave strategjike të planit të mëparshëm.

Prioritete	Objektiva afatmesëm	Tregues performance	Statusi i realizimit
Prioriteti 1 Përmirësimi i rezultateve të cilësisë në shkollë	1.1. Të rritet % e kalueshmërisë dhe nota mesatare në Lëndët e Maturës Shtetërore	1.1.1. % e Kalueshmërisë dhe nota mesatare, në provimet Maturë Shtetërore, më e lartë e krahasuar me dy vite më parë	Bazuar në rezultatet e Maturës Shtetërore rezulton që në lëndët Gjuhë shqipe dhe letësi, gjuhë e huaj anglisht, teori profesionale për të dy drejtimet e shkollës hoteleri-turizëm dhe teknologji ushqimore ka patur rezultate progressive në rritje, të kënaqshme si në kalueshmëri ashtu edhe në notë mesatare. Në lëndën matematikë kalueshmëria dhe nota

			mesatare janë jo shumë të larta por edhe në këtë lëndë a patur një rritje si në notë ashtu dhe në kalueshmëri. **Objektivi është realizuar në masën 100%**
	1.3. Të ulet numri i mungesave të nxënësve në shkollë	1.3.1. Ulja e numrit të mungesave krahasuar me 1 vit më parë	Bazuar në analizat vjetore, në evidencat e mungesave rezulton që numri i mungesave nga viti në vit ka luhatje. Për vitin shkollor 2019-2020 krakaruar me një vit më parë ka ulje të numrit të mungesave, ulje ka edhe për vitin në vazhdim 2020-2021. Për vitët 2021-2022 dhe 2022-2023 ka rritje të mungesave krakasuar me një vit më parë, kjo edhe për faktin e kushteve në të cilën u zhvillua mësimi me dy turne dhe në një shkollë tjerër. **Objektivi është realizuar pjesërisht**.
	1.4. Të ulet numri i nxënësve të larguar nga shkolla	1.4.1. Numri i nxënësve të larguar nga shkolla, krahasuar me 2 vite më parë	Bazuar në analizat vjetore, në evidencat e mungesave dhe largimeve nga shkolla, rezulton që numri i largimeve ka qenë më i lartë në vitin shkollor 2019- 2020 më pas numri i nxënësve të largur ka qenë më i vogël në vitet në vazhdim krahasuar me këtë vit. **Objektivi është realizuar por duhet të përmirësohet në vazhdim**
Prioriteti 2 Përmirësimi i cilësisë së përgatitjes profesionale të nxënësve dhe	2.1. Të rritet numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset	2.1.1 Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me bizneset të jetë progresiv	Bazuar në dokumentacionin e koordinatorit të biznesit rezulton që: Numri i bizneseve për vitin 2019-2020 ka qenë 80, për vitin 2020-2021 ka qenë 200, për vitin 2021-2022 ka qenë 237, për vitin 2022-2023 ka qenë 283. Nga rezultatet

bashkëpunimi me institucione trajnimi europiane			shihet që numri i bizneseve nga viti në vit është rritur. **Objektivi është realizuar në masën 100%**
	2.2. Të rritet numri i nxënësve që kryejnë praktika gjithëvjetore në biznes	2.2.1. Data Base për numrin e nxënësve që realizojnë praktika profesionale gjithëvjetore/fundjavë/verore	Bazuar në dokumentacionin e koordinatorit të biznesit rezulton që: Përqindja e nxënësve që kryejnë praktikën për vitin 2019-2020 ka qenë 30%, për vitin 2020-2021 ka qenë 64% për vitin 2021-2022 ka qenë 80% për vitin 2022-2023 ka qenë 90% kundrejt totalit që duhet të realizojnë praktikat në biznes. Nga rezultatet shihet që përqindja e nxënësve që kryejnë praktikën nga viti në vit është rritur. **Objektivi është realizuar në masën 100%**
	2.3. Të përmirësohet nota mesatare e nxënësve në lëndët /modulet profesionale	2.3.1. Evidencat/Statistikat për rezultatet vjetore të nxenesve (Notë mesatare e rritur në lëndët/modulet profesionale, krahasuar me një vit më parë)	Bazuar në evidencat e rezultateve të departamenteve, në analizën vjetore të shkollës kryesisht për lëndët profesionale rezulton që: ka një rritje të lehtë të notës mesatare nga viti në vit në pjesën më të madhe të lëndëve profesionale por jo për të gjitha. **Objektivi është realizuar pjesërisht.**
	2.7. Të rritet numri i pjesëmarrjeve në aktivitete kombëtare/rajonale/ndërkombëtare	2.7.1 Evidenca dhe vlerësime nga pjesëmarrjet në aktivitete	Bazuar në evidencat e pjesmarrjes në aktivitete të ndryshme kombëtare/rajonale/ndërkombëtare rezulton se nga viti në vit është rritur numri i pjesmarjeve në këto aktivitete. Si pasojëe zhvillimeve dhe mundësive të shumta nga ministria përkatëse në varësi të shkollave profesionale, bashkëpunimit me OJF, ka patur bashkëpunime me shumë projekte si OEAD kryesisht për barazinë gjinore por edhe në

			mbështetje të zhvillimit të njësisë zhvillimore për rritjen e kapaciteteve. Projekti Vet to Vet për imobilitete të nxënëxve dhe mësimdhënësve në Alba Itali dhe Lion Francë **Objektivi është realizuar plotësisht.**
	2.7. Të rritet numri i pjesëmarrjeve në aktivitete kombëtare/rajonale/ndërkombëtare	2.7.1 Evidenca dhe vlerësime nga pjesëmarrjet në aktivitete	Bazuar në evidencat e pjesmarrjes në aktivitete të ndryshme kombëtare/rajonale/ndërkombëtare rezulton se nga viti në vit është rritur numri i pjesmarjeve në këto aktivitete. Si pasojë zhvillimeve dhe mundësive të shumta nga ministria përkatëse në varësi të shkollave profesionale, bashkëpunimit me OJF, ka patur bashkëpunime me shumë projekte si OEAD kryesisht për barazinë gjinore por edhe në mbështetje të zhvillimit të njësisë zhvillimore për rritjen e kapaciteteve. Projekti Vet to Vet për imobilitete të nxënëxve dhe mësimdhënësve në Alba Itali dhe Lion Francë **Objektivi është realizuar plotësisht.**
Prioriteti 3 Punësimi dhe vetëpunësimi i nxënësve, pas përfundimit të shkollës	3.1 Të rritet numri i nxënësve të certifikuar, të punësuar /sipërmarrës, në tregun e punës 3.2 Të rritet bashkëpunimi me Zyrat e Punës dhe punëdhënës, për të rritur numrin e nxënësve të punësuar	3.1.1. Data Base nga gjurmimi për shifrat e punësimit, pas përfundimit të shkollës 3.1.2. Grafikë/ tabela me të dhëna nga procesi i paragjurmimit	Bazuar në rezultatet e gjurmimit rezulton që për drejtimin Hoteleri- Turizëm nga viti 2017 deri në 2021numri I nxënësve të punësur është në rritje përkatësisht 61%, 63%, 64%, 66%, 81%. Edhe drejtimi teknologji ushqimore ka patur rritje nga 30% në vitin 2017 në 56% në 2021. Problem ngelet drejtimi Teknologji ushqimore që nuk janë të punësuar në drejtimin për të cilën kanë përfunduar shkollën.

		3.2.1. Të dhëna statistikore për vendet e zëna në punë, nga nxënësit tanë	**Objektivi është realizuar plotësisht**
Prioriteti 4 Trajnimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve	4.1 Të realizohet trajnimi didaktik i mësimdhënësve në masën 100% të 4.3 Të rritet numri i trajnimeve të brendshme të realizuara nga institucioni mësimdhënësve	4.1.1. Database e mësimdhënësve të trajnuar në Didaktikë 4.1.2. Përgatitje ditore cilësore 4.1.3. Performanca e mësimdhënësve në fund të vitit shkollor 4.3.1. Numri i trajnimeve të kryera nga ZHVP dhe drejtoria e shkollës	Bazuar në dokumentacionin e ZH.V.P në database e mësimdhënësve rezulton se të gjithë mësimdhënësit kanë realizuar trajnimin e bazat e ditaktikës. Shkolla me fondet e saj ka realizuar trajnim të stafit bazuar në kërkesat dhe nevojat e stafit për trajnime. Janë realizuar orë të hapura me tematika të ndryshme me qëllim shkëmbim përvoje. Objektivi është realizuar 100 %
	\4.4 Të rritet numri i orëve mësimore, ku përdoret TIK në mësimdhënie, duke përdorur metoda për mësim të kombinuar	4.4.1 Numri i trajnimeve të kryera për metodat e mësimdhënies si dhe numri i orëve ku përdoret TIK	Bazuar në kontrollet tematike të drejtorisë, në realizimin e orëve të hapura në departamente rezulton se ka një rritje të lehtë të përdorimit të TIK në mësimdhënie. Ka nevojë për përmirësim.
	Bazuar në realizimin e planit afatmesëm të mëparshëm rezukton se ai është realizuar në masën mbi 85 % të objektivave.		

3.3. Analiza SWOT

<table>
<tr>
<td>Pikat e forta
1. Mësimdhënës të trajnuar
2. Mësimdhënës autorë tekstesh/materialesh mësimore
3. Reparte praktikash profesionale me mjete dhe pajisje profesionale bashkëkohore (Hoteleri)
4. Numër i madh biznesh partnere (283)
5. Biznese shumë të interesuar për bashkëpunim me shkollën
6. Krijimi i imazhit pozitiv të shkollës në komunitet
7. Bordi drejtues është aktiv dhe mbështetës
8. Shkolla jonë, pjesë e Rrjetit të shkollave europiane të Ekselencës
9. Jemi pjesë e projekteve dhe bashkëpunimit me OeaD
10. Menaxhim efikas i institucionit
11. Marketing intensiv për institucionin
12. Aktivitete të shumta profesionale edhe me parnerët
13. Trajnime intensive të mësimdhënësve dhe drejtuesve nga buxheti i shkollës, me ekspertë të liçensuar, vetëtrajnime, trajnime nga donatorë, AKPA, AKAFPK
14. Mësimdhënës që vijnë nga tregu i punës, me përvojë të gjatë profesionale
15. Partnerë në 2 projekte ERASMUS, përvojë për mësimdhënës dhe nxënës</td>
<td>Pikat e dobëta
1. Numri i konsiderueshwm i nxënësve të larguar.
2. Mungesa e aftësive të buta tek nxënësit e konstatuar edhe nga biznesi
3. Numri i ulët i punësimit për drejtimin teknologji ushqimore, edhe ata që punësohen janë jashë profilit.
4. Largësia e shkollës nga qendrat e banimit
5. Nxënës me rezultate të ulta nga shkollimi 9-vjeçar
6. Mësimdhënës të rinj, që kanë nevoja për trajnim të vazhduar</td>
</tr>
<tr>
<td>Mundësitë
1. Bashkëpunim me bizneset për trajnime profesionale nxënësish mësimdhënësish
2. Bashkëpunim me institucionet e tjera, që mund të kontribuojnë për shkollën</td>
<td>Sfidat
1. Rifreskimi i reparteve profesionale me mjete dhe pajisje pune sipas kërkesave të kurrikulës
2. Përdorimi i konviktit si një Hotel Mësimor për nxënësit</td>
</tr>
</table>

3. Mësimdhënës trajnerë për mësimdhënës të tjerë 4. Bashkëpunim i suksesshëm me bizneset për realizimin e praktikave profesionale të nxënësve 5. Histori suksesi i ish nxënësve të shkollës si model për të rinjtë 6. Bashkëpunim i suksesshëm me sektorin privat për të realizuar orë të përbashkëta mësimore, vizita mësimore, trajnime etj.	3. Kthimi i shkollës në një qendër të madhe trajnimesh profesionale dhe qendër komunitare 4. Fatkeqësi natyrore, epodemitë 5. Mungesa e miratimit të akteve nënligjore për vetfinancim të shkollave profesionale. 6. Informaliteti i biznesve. 7. Rënia e numrit të nxënësve që përfundojnë klasën e 9 të. 8. Përqindje e lartë e nxënësve që vijnë nga një kontekst social vulnerable.

4 Vizioni, misioni e kompetencat dalluese

Vizioni	Përgatitja e punonjësve të kualifikuar në industrinë e mikpritjes dhe industrisë ushqimore duke aspiruar të bëjë diferencën në ofrimin e alternativave të kualifikimeve profesionale, cilësore, inovative dhe konkurruese, në partneritet të ngushtë me bizneset relevante, për integrimin e shpejtë dhe të denjë të nxënësve në tregun e punës.
Misioni	Ne ofrojmë kualifikime profesionale sipas kërkesave të tregut të punës, mbështetur në metodat inovative të mësimdhënies, përdorimit të teknologjisë së fundit, mjediseve bashkëkohore të mësimit, stafit të kualifikuar, programeve të hartuara dhe zbatuara në bashkëpunim me biznesin me qëllim përgatitjen e profesionistëvë të aftë dhe qytetarëve të denjë. Edukimi i elementeve të qytetarisë dhe nxitja tek nxënësit e shprehive praktike, të të mendurarit krijues dhe iniciativës me qëllim përshtatjen e tij në tregun e punës. Ne: ➢ Ofrojmë programe cilësore të përgatitjes profesionale të nxënësve, duke i pajisur ata me kompetencat e kërkuara në tregun e punës, nga mësimdhënës të kualifikuar. ➢ Ofrojmë arsimim fleksibël dhe kushte bashkëkohore të realizimit të praktikave profesionale.

	➢ Ofrojmë pjesëmarrjen e të gjithëve, pa asnjë dallim, duke mësuar, bashkëpunuar e duke e duke ndarë me të tjerët të njëjtat përvoja të të nxënit. ➢ Nxisim aftësitë e sipërmarrjes dhe të menaxhimit te nxënësit tanë. ➢ Ofrojmë mundësi të shumta për pjesërmarrje në aktivitete profesionale brenda dhe jashtë vendit, pasi jemi pjesë e rrjetit europian të shkollave hoteliere. ➢ Ofrojmë mundësi të shumta për argëtim dhe sport, pasi kemi traditë në këtë drejtim. ➢ Prindërit dhe parnerë të tjerë, janë pjesë përbërëse e të gjithë aktivitetit shkollor dhe edukativ.
Kompetencat dalluese	Duke qenë shkolla e parë e "Hoteleri-Turizmit "në Shqipëri, ne jemi shkolla që ndërtuam për herë të parë këtë drejtim mësimor dhe këtë profesion, të ndihmuar dhe mbështetur edhe nga parnerët austriakë, nëpëmjet projekteve të zbatuara nga Qeveria Austriake nëpërmjet zyrës për arsim në Shqipëri, K-Kontakt/OeaD. Shkolla jonë është aktualisht shkolla me imazhin më të mirë të shkollave që ofrojnë "Hoteleri –Turizëm" në Shqipëri, një shkollë e vlerësuar nga bizneset por edhe nga donatorët e huaj që mbështesin AP në vend. Me aftësimin profesional të nxënësve tanë në ambiente profesionale të praktikave në shkollë, me mjete dhe pajisje bashkëkohore, nga mësimdhënës profesionistë të njohur të fushës, me mbështetje të madhe nga Bordi Drejtues dhe bizneset partnere të shkollës, aktualisht ofrojmë profile shumë të larmishme dhe të kërkuara që plotësojmë nevojat e tregut të punës me punonjës të kualifikuar në të gjithë vendin. Nxënësit tanë realizojnë mbi 50 % të orëve praktike të planifikuara në kurrikul, në bizneset e fushës. Ata janë sot menaxherë dhe drejtues, punonjës të denjë në tregun e punës duke konkuruar me kolegët e tyre me përvojë të gjatë pune, shpesh herë edhe si sipërmarrës. Një pjesë e ish nxënësve të shkollës sonë, punojnë sot me profesionalizëm edhe në tregun europian të punës dhe diploma e tyre tashmë është lehtësisht e njohur nga tregu europian, pas referencimit të KSHK me KEK. Shkolla prej vitesh njihet edhe në rrjetin e shkollave europiane të Hotelerisë, si pjesë e Rrjetit të shkollave të Ekselencës, si e vetmja anëtare e këtij rrjeti nga Shqipëria, por edhe si pjesëmarrëse në shumë aktivitete, konkurse dhe prezantime, të vlerësuara me çmime dhe medalje. Mësimdhënësit e shkollës janë hartuesit e materialeve mesimore që ofrohen për nxënësit e Hoteleri-Turizmit, në shkollat shqiptare si dhe anëtarë të grupeve të hartimit të dokumenteve të shumta kurrikulare. Ata janë trajnerë për mësimdhënës të tjerë nga shkollat e Hotelerisë. Numri i madh i bizneseve që i drejtohen çdo ditë shkollës për të gjetur punonjës të përgatitur profesionalisht, tregon më së miri se cili është imazhi i shkollës tonë sot. Për këto arsye shkolla jonë është vlerësuar si shkollë ekselence **"për të nxënët në vendin e punës"** nga ETF.

	1-Bashkëpunimi 2-Gjithpërfshirja 3-Inovacioni 4-Mjedisi miqësor 5-Profesionalizm 6-Transparenca 7-Partneritetet 8-Integriteti

5.PRIORITETET,OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE TREGUESIT E ARRITJEVE/PERFORMANCËS

Prioritete	Objektiva	Tregues përformance
1.Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës	-Vlerësim periodik i nevojave të tregut	Numri i tryezave të dialogut të realizuara në vit Numri i bizneseve pjesëmarrëse
	- Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet aktuale dhe të reja.	Numri i paisjeve/laboratoreve të reja
	-Hapja e një kualifikimi të nivelit të V KSHK-së, bashkëkohore për të dyja drejtimet	Numri i kualifikimit të nivelit të V të KSHK-së

	- Ritje profesionlae e mësimdhënësve nga shkolla dhe biznesi	Të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në kualifikimet të trajnohen nga shkolla dhe biznesi
2.Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës	- Përzgjedhja e biznesese për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me kompetencat e kërkuara	Numri i bizneseve të përzgjedhura me të gjitha postet e punës
	-Trajnim i mentorëve të bizneseve	Trajnimi i të pakten 80% të mentorëve të bizneseve
	- Përfshirja në kurrikulën në bazë shkolle e "Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."	Të gjitha kurrikulat e hartuara në shkollë për kulturën profesionale kanë të përfshirë edhe "Aftësitë e Buta, digjitale dhe të gjelbra"
	Ngritja e strukturave të brëndshme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	Të gjithë anëtarët e strukturave të brëndshme kapacitohen për monitorimin dhe garantimin e cilësisë
3.Mësimdhënie inovative	-Kapacitimi i të gjithë mësimdhënësve për pedagogjinë digjitale dhe përdorimin e materialeve mësimore digjitale	Të gjithë mësimdhënësit e lëndëve profesionale kapacitohen për pedagogjinë digjitale për përdorimin e materialeve mësimore digjitale
	-Kurrikula të përditësuara	Të gjitha planet lëndore dhe programet e moduleve të praktikave profesionale rishikohen duke përfshirë përdorimin e teknologjisë dhe metodat inovative të mësimdhënies

5 Prioritetet, objektivat strategjike dhe treguesit e aritjeve/ performances

.KALENDARI I VEPRIMTARIVE KRYESORE, MONITORIMI E BUXHETIMI

Prioriteti 1. Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës **Objektivi 1. Vlerësim periodik i nevojave të tregut**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Tryeza dialogu me bizneset partnere dhe biznese të tjera	Një tryezë dialogu për secilin drejtim	x	x	x	x	Drejtoria Njësia e Zhvillimit	Drejtoria Njësia e Zhvillimit	1 herë në vit	Listë-prezenca Raporte	Shkolla
Tryeza dialogu me istitucionet lokale	Realizohen 2 tryeza dialogu	x		x		Drejtoria Njësia e Zhvillimit	Drejtoria Njësia e Zhvillimit	1 herë në dy vite	Listë-prezenca Raporte	
Tryeza dialogu me komunitetin	Realizohen 2 tryeza dialogu	x		x		Drejtoria Njësia e Zhvillimit	Drejtoria Njësia e Zhvillimit	1 herë në vit	Listë-prezenca Raporte	
Gjurmimi i të diplomuarave	Cdo vit gjurmohën ish maturantët e diplomuar një vit më parë.	x	x	x	x	Njësia e Zhvillimit	Drejtoria Njësia e Zhvillimit	1 herë në vit	Listë-prezenca Raporte	

Prioriteti 1. Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës **Objektivi 2. Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet egzistuese dhe të reja**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Vënia në funksion e repartit të qumështit	Repart funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës			x		Drejtoria	Drejtoria	Në fund të vitit	Marrja në dorëzim	Buxheti i planifikuar
Ndërtimi i një reparti për prodhimin e pijeve dhe përpunimin e fruta perimeve.	Repart funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës		x			Drejtoria	Drejtoria	Në fund të vitit	Marrja në dorëzim	Buxheti i planifikuar
Ngritja e laboratorëve të TIK për gjitha kualifikimet	Kabinat funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	x		x		Drejtoria Ministria	Drejtoria	Në fund të vitit	Marrja në dorëzim	Buxheti i planifikuar
Ristrukturimini i bar-restorantit edhe me paisje të tjera.	Kabinat funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	x				Drejtoria OEAD	Drejtoria OEAD		Libri i inventarit	Pprojekt
Mirëmbajtja dhe pasurimi i laboratorëve	Laboratorë funksionalë në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	x	x	x	x	Drejtoria	Drejtoria	1 herë në gjashtë muaj	Fatura shërbimi dhe blerje	Shkolla

Prioriteti 1. Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës **Objektivi 3. Hapja e një kualifikimit të nivelit V KSHK-së, për të dyja drejtimet.**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Orientimi në karriere	Cdo vit realizohet orientim në karrierë	x	x	x	x	KOK	KSC Drejtoria	1 herë në vit	Materialet e orientimit Pyetësorë Foto	Shkolla
Promovimi i ofertës së re	Cdo ofertë e re promovohet tek target grupet e synuara	x	x	x	x	KMI	KSC Drejtoria	1 herë në vit	Materiale promovuese Rrjetet sociale Ëebsite i shkollës	Shkolla
Pasurimi i kurrikulës	Numri i kurrikulave të pasuruara sipas kualifikimeve të reja të hapura	x	x	x	x	KZHK Përgjegjësit e departamente ve	KSC Drejtoria	Sipas rastit	Kurrikulat e reja	
Përgatitja e infrastrukturës	Planifikimi i buxhetit	x	x	x	x	Përgjegjësit e departamente ve Njësia e Zhvillimit Financa Drejtoria Bordi	Drejtoria Bordi	Sipas rastit	Mjedise mësimore në përputhje me nevojat	Shkolla

Prioriteti 1.Oferta arsimore të reja sipas kërkesës së tregut rajonal **Objektivi 4.** Ritje profesionlae e mësimdhënësve nga shkolla dhe biznesi										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Identifikimi i nevojave për trajnime	Pyetësorët e vetëvlerësimit	x	x	x	x	KZHVP Drejtoria	NJZH Drejtoria	1 herë në vit	Raporti i analizës së nevojave	
Hartimi I planit të trajnimeve/Workshopeve	Plani i ZHVP-së	x	x	x	x	KZHVP Drejtoria	NJZH Drejtoria	1 herë në vit	Raporti i analizës së nevojave	
Identifikimi i bizneseve potenciale për të ofruar trajnime/praktikë profesionale për mësimdhënësit	Profilet e bizneseve të identifikuara	x	x	x	x	KMB Drejtoria	NJZH Drejtoria	1 herë në vit	Raporti i KMB	
Trajnimi i mësimdhënësve sipas planifikimit	Numri i trajnimeve dhe numri i mësimdhënësve të trajnuar	x	x	x	x	KZHVP Drejtoria Bizneset	NJZH Drejtoria	1 herë në vit	Raporti i KZHVP	Shkolla Projekte Biznese

Prioriteti 2. Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës **Objektivi 1. Përzgjedhja e biznesese për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me kompetencat e kërkuara**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Anketime/pyetësor me nxënës dhe biznese	Anketimet /pyetësorët e realizuar	x	x	x	x	Drejtoria	Drejtoria	1 herë në vit	Raporti përmbledhës	
Analizë e rezultateve të pyetësorëve	Analiza	x	x	x	x	Drejtoria KMB KZHK	Drejtoria NJZH	1 herë në vit	Procesverbali i takimit	
Workshop-e me bizneset	Numri i bizneseve pjesëmarrëse në Workshope	x	x	x	x	Drejtoria KMB KZHK	Drejtoria NJZH	1 herë në vit	List-prezenca Materialet e Workshopit	Shkolla
Riorganizimi praktikës profesionale	Profilet e bizneseve të përzgjedhura Grafiku i praktikës	x	x	x	x	Drejtoria KMB KZHK	Drejtoria NJZH	1 herë në vit	Database me të dhënat e bizneseve dhe shpërndarjes	Shkolla

Prioriteti 2. Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës **Objektivi 2.Trajnim i mentorëve të bizneseve**										
	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Identifikimi i nevojave për trajnim	Numri i pyetësorëve	x		x		KMB Drejtoria	Drejtoria NJZH	Sipas rastit	Raporti i pyetësorëve	
Workshope me bizneset mbi rëndësinë e trajnimit të mentorëve	Numri i Workshopeve të realizuara	x		x		KMB Drejtoria	Drejtoria NJZH	Sipas rastit	Listë-prezenca Materialet informuese	Shkolla Projekte
Përgatitja e moduleve të trajnimit	Modulet e trajnimit	x		x		Specialist	Drejtoria	Sipas rastit	Modulet e trajnimit	Shkolla Projekte
Kalendari i trajnimeve	Programi i trajnimit	x		x		Drejtoria KMB	Drejtoria NJZH	Sipas rastit	Programi i trajnimit	
Konsultim me mentorët i programit të trajnimit	Numri i mentorëve të përfshirë në konsultim	x		x		Drejtoria KMB	Drejtoria NJZH	Sipas rastit	Listë prezenca E mail	
Realizimi i trajnimit	Numri i mentorëve të trajnuar	x	x	x	x	Drejtoria KMB	Drejtoria NJZH	Në fund të programit të trajnimit	Raport Rregjistër pjesëmarrje	Shkolla Projekte

Prioriteti 2. Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës **Objektivi 3. Përfshirja në kurrikulën në bazë shkolle e "Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Trajnim i mësimdhënësve për **"Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."**	Numri i mësimdhënësve të trajnuar	x	x	x	x	Drejtoria KZHVP	Drejtoria	Sipas rastit	Materialet e trajnimit Certifikatat e trajnimit	Projekte
Integrimi i **"Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."**në planifikimet lëndore	Numri i planeve lëndore dhe programeve të moduleve në të cilat janë integruar Aftësitë e Buta	x	x	x	x	Drejtoria KZHK	Drejtoria KZHK	Çdo vit	Planifikimet lëndore Procesverble të takimeve	
Krijimi i bibliotekës së praktikave të mira për përdorimin e **"Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."**	Numri i përvojave pozitive të realizuara	x	x	x	x	KZHVP	KZHVP	Çdo vit	Biblioteka e praktikave të mira	
Mbledhje sistematike e informacionit nga partneret mbi **"Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."** të nxënësve në vendin e punës	Analizë sasiore dhe cilësore	x	x	x	x	Drejtoria KMB	Drejtoria KMB	Çdo vit	Raporte të pyetësorëve	

Prioriteti 2. Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës **Objektivi 4. Ngritja e strukturave të brëndshme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Identifikimi i nevojave për instrumentet e monitorimit dhe garantimit të cilësisë	Intervistat me drejtuesit e shkollës ,përgjegjësit e departamenteve dhe NJZH	x	x	x	x	Drejtoria KZHVP	Drejtoria	Çdo vit	Raport mbi nevojat	
Hartimi i instrumenteve të monitorimit dhe garantimit të cilësisë	Numri i instrumentave të përgatitur	x	x	x	x	Ekspertë të fushës	Drejtoria NJZH	Çdo vit	Instrumentet e monitorimit	
Trajnim i strukturave të brëndshmë	Numri i trajnimeve të realizuara	x	x	x	x	Ekspertë të fushës	Drejtoria KZHVP	Çdo vit	Listë-prezencë Raporte	
Vlerësimi i procesit të monitorimit	Shpeshtësia e vlërësimit të procesit	x	x	x	x	Ekipi i vetëvlerësimit	Drejtoria KSC	Çdo vit	Raporti i vetëvlerësimit	

Prioriteti 3. Mësimdhënie inovative **Objektivi1. Kapacitimi i të gjithë mësimdhënësve për pedagogjinë digjitale për përdorimin e materialeve mësimore digjitale**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Identifikimi i nevojave për trajnime	Pyetësor me mësimdhënësit	x	x	x	x	KZHVP	PNJZH KZHVP	Çdo vit	Raport përmbledhës i pyetësorëv të vetëvlerësimit	
Hartimi planit të trajnimeve	Plani i trajnimeve	x	x	x	x	KZHVP	PNJZH KZHVP	Çdo vit	Plani i trajnimeve	
Realizimi i trajnimeve	Numri i trajnimeve dhe mësimdhësve të trajnuar	x	x	x	x	Ekspertë të fushës	KZHVP	Çdo vit	Listë prezenca Certifikatat e trajnimit	Shkolla
Zhvillimi i orëve mësimore model	Numri i orëve të realizuara	x	x	x	x	DREJTORIA KZHVP	Drejtoria KZHVP	Çdo vit	Raport vlerësimi	

Prioriteti 3. Mësimdhënie inovative **Objektivi 2 Kurrikula të përditësuara (nga konsultimet me biznesin)**										
Veprimtaritë	Indikatori	Afati				Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027					
Krijimi i grupeve të punës për rishikimin e kurrikulave	Përfshirja në grupin e punës përfaqësues nga bizneset dhe nxënësit(nga një për secilin kualifikim)	x	x	x	x	Drejtoria KZHK	Drejtoria	Çdo vit	Grupet e punës (Një grup pune për secilin departament/ekip lëndor)	
Analizë mbi hartimin e planeve dhe programeve mësimore	Analizë sasiore dhe cilësore	x	x	x	x	Grupi i punës	Drejtoria KZHK	Çdo vit	Raport i analizës	
Rishikimi i metodave mësimore në planet lëndore/programet mësimore	Numri i planeve/programeve mësimore të rishikuara	x	x	x	x	KZHK Mësimdhënësit	Drejtoria KZHK	Çdo vit	Planet lëndore/programet mësimore të rishikuara	
Monitorimi i zbatimit të kurrikulës	Numri i orëve të monitoruara	x	x	x	x	Drejtoria	Drejtoria	Çdo vit	Instrumentet e plotësuara për orët e monitoruara	